

Termat e Referencës: “Ekspert për krijimin e një dokumenti strategjik për krijimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e korridoreve të zjarrit në Parkun Kombëtar të Prespës-PKP”, për AdZM Korçë, aktiviteti 1.5

1. Hyrje

Parku Kombëtar i Prespës-PKP përbën një ekosistem të rëndësishëm natyror me vlera të larta ekologjike dhe biodiversitet të pasur. Megjithatë, ndryshimet klimatike, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe faktorët antropogjenë kanë rritur rrezikun e zjarreve të pyjeve.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), përmes Grantit të financuar nga PONT në Parkun Kombëtar të Prespës-PKP (PA_024), duke zbatuar Planin Operacional 2025 të dakordësuar për këtë zonë të mbrojtur, është e angazhuar për të minimizuar këto rreziqe dhe si rrjedhim ka analizuar se është e nevojshme të hartohet një dokument strategjik mbi krijimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e korridoreve të zjarrit në park (PKP).

2. Objektivat

Objektivat kryesorë të angazhimit të ekspertit janë si më poshtë:

- a. Të hartojë dhe të prodhojë një dokument strategjik teknik, që përshkruan metodologjitë dhe praktikën më të mira për krijimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e korridoreve të zjarrit në Parkun Kombëtar të Prespës-PKP.
- b. Dokumenti do të ofrojë udhëzime praktike për Administratën e Zonave të Mbrojtura të Korçës (AdZM Korçë) dhe do të shërbejë si bazë për planifikimin dhe zbatimin e masave të parandalimit të zjarreve, kjo në bashkëpunim edhe me palët e tjera.

3. Detyrat dhe Përgjegjësitë

Fokusi i detyrës do të jetë Parku Kombëtar i Prespës-PKP sipas objektit të procedurës shërbim konsulence “Ekspert për krijimin e një dokumenti strategjik për krijimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e korridoreve të zjarrit në Parkun Kombëtar të Prespës-PKP” për AdZM Korçë lidhur me PKP.

Eksperti do të ketë përgjegjësitë e mëposhtme:

- *Analizë e situatës aktuale:* Vlerësimi i rrezikut të zjarreve në Parkun Kombëtar të Prespës-PKP përfshirë analizën e faktorëve natyrorë dhe njerëzorë që kontribuojnë në këtë rrezik.
- *Identifikimi i zonave kritike:* Identifikimi i zonave me rrezik të lartë për zjarre dhe përcaktimi i korridoreve strategjike për ndërhyrje në park (PKP).
- *Përpilimi i kriterëve teknike:* Përcaktimi i gjerësisë, strukturës (krijimi) i korridoreve të zjarrit dhe teknikave të mirëmbajtjes së tyre në park (PKP), duke u bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare dhe kontekstin lokal.
- *Përcaktimi i masave për menaxhim të qëndrueshëm:* Strategji për mirëmbajtjen afatgjatë të korridoreve të zjarreve dhe integrimin e tyre në planin e menaxhimit të Parkut Kombëtar të Prespës-PKP.

- *Hartimi i rekomandimeve për institucionet dhe komunitetet lokale:* Propozime për përfshirjen e komuniteteve në masat parandaluese dhe ndërgjegjësimin e tyre mbi rrezikun e zjarreve.
- *Produkti final (dokumenti strategjik teknik) sipas objektit të procedurës duhet të dorëzohet në format pdf dhe word, në mënyrë elektronike dhe fizikisht.*

4. Kualifikimet dhe Eksperienca

Eksperti duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Diplomë universitare në inxhinieri pyjore, shkenca mjedisore, menaxhim të burimeve natyrore ose fusha të ngjashme
- Eksperienca të paktën 5-vjeçare në menaxhimin e pyjeve, parandalimin e zjarreve të pyjeve ose menaxhimin e zonave të mbrojtura.
- Njohuri mbi praktikën më të mira ndërkombëtare për menaxhimin e zjarreve dhe krijimin e përdorimit të korridoreve të zjarrit.
- Aftësi të mira në hartimin e dokumenteve strategjike dhe teknike.
- Njohuri të shkëlqyera të gjuhës shqipe dhe aftësi për të raportuar qartë.

5. Kohëzgjatja e konsulencës dhe dorëzimi i Produktit

Shërbimi i konsulencës fillon me nënshkrimin e kontratës respektive me ekspertin e shpallur fitues dhe do të përfundojë me dorëzimin e produktit final (dokumenti strategjik teknik) **brenda 7 (shtatë) javësh nga nënshkrimi i kontratës**, sipas objektit të procedurës shërbim konsulence “Ekspert për krijimin e një dokumenti strategjik për krijimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e korridoreve të zjarrit në Parkun Kombëtar të Prespës-PKP” për AdZM Korçë lidhur me PKP.

6. Buxheti

Buxheti për kryerjen e procedurës së prokurimit shërbim konsulence i referohet zbatimit të linjave të buxhetit të përcaktuara në Planin Operacional 2025 të grantit të financuar nga PONT për PKP, saktësisht:

- Aktiviteti Nr. 1.5 me objekt "Ekspert për krijimin e një dokumenti strategjik për krijimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e korridoreve të zjarrit në Parkun Kombëtar të Prespës-PKP" për AdZM Korçë lidhur me PKP, **parashikuar në vlerën maksimale 4,950 (katër mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) euro, ku përfshihet me tvsh ose 15% tatim në burim.**

7. Mënyra e Aplikimit dhe afati

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë aplikimin e tyre me:

- CV-në e detajuar.
- Ofertën financiare sipas buxhetit të përcaktuar në planin operacional 2025 sipas pikës 6 më sipër

në adresën zyrtare të emailit: info@akzm.gov.al

Afati për aplikim është deri më datë **23 prill 2025** (përfshirë).